

NE EMER TE POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NE GJILAN DEGA NË VITI**, Departamenti i pergjithshem, divizioni civil si gjykatë e shkallës së parë, sipas gjyqtarit Nexhat Aliu me Sekretare Juridike Azize Rama, duke vendosur në qështjen kontestimore të paditësit N.N nga fsh.N kundër të paditurëve N. N , N, N.N . që te gjithe nga fsh.N..K.Viti, baza e kontestit vërtetim i pronsisë, e pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqsor, oral dhe publik, me datën 12.04.2017, shpallë këtë:

**A K T G J Y K I M**

**APROVOHET** kerkesepadia e paditsit E. E.. nga fsh... K.Viti, **i njihet** e drejta e pronsise ne ngastrën katastrale nr. XXX, vendi i quajtur " ...XXXX", në sipërfaqe prej XXX m2, ne emer te N N (N), ngastra nr.XXX ne vendin e qujtur M,. ..." ne siperfaqe prej XXXX, në emer te XX (XX), ngastra nr.XXX ne vendin e qujtur "XXXX" ne siperfaqe prej XXX, ne emer te X.X dhe ngastra nr.XXX në vendin e quajtur "XXXX" në sipërfaqe prej XXX m2, zona katastrale XXX, **ne baze te shitblerjes.**

**OBLIGOHEN** të paditurit XX (XXX) XX,XXX (N ) S,N (S) S dhe A.. (S.) S qe t'ia pranojnë paditësit te drejten e pronsise dhe te durojn qe ngastrat kadastrale te regjistrohet ne emer te tij.

**OBLIGOHET** Sherbimi Katastral në Viti, që të bëjë ndryshimin në bazë të këtij aktgjykimi.

**A r s y e t i m**

Paditësi E.E ka deklaruar: mbetem në tërsi pran padisë dhe kërkes padis dhe kerkoj nga gjykata që të me njihet e drejta e pronsisë dhe atë në ngastrën katastrale nr.XXX-0 në vendin e quajtur 'XXXX, në sipërfaqe prej XXXm2, si dhe ngastra nr.XXX, ne vendin e quajtur 'XXXX sipërfaqe prej XXm2, ngastra nr. XXX, në vendin e quajtur 'XXXX me sipërfaqe prej XXXm2, si dhe ngastra nr.XXXX, në vendin e quajtur 'XXXXX me sipërfaqe prej XXXm2, të gjitha këto ZK.XXXX paditësi këto parcela i kishte blerë me tëper se 30 vite, ku ka hyre në posedim dhe shfrytzim pa u penguar nga askush.

I padituri R B nipi i M.... (A.) deklaron: nuk e kundershtoj padine as kerkes padine ngase është e vërtet se paditesi E. E.e kabler ngastrën me nr ...XXX, nga babgjyshi im para disa vitesh.

I Padituri R.. B.deklaron :se gjykata në seancat tjera mund të zhvillojë pa prezencen time nga se nuk kam tjetër qka te deklaroj pos kesaj qka e thash në këtë shqyrtim gjyqsor.

I Padituri N...S... djali i N... S... deklaron:nuk e kundërshtoj padine as kerkes padine ngase është e vërtet se ngastren katastrale XXX-XX e ka blere paditesi para disa viteve nga babai im , dhe e ka paguar ne tërësi.

I Padituri N.. S.. deklaron :se gjykata në seancat tjera mund ti zhvillojë pa prezencen time nga se nuk kam tjetër qka te deklaroj pos kesaj qka e thash në këtë shqyrtim gjyqësor.

I Padituri N.. S., nipi i F. S. deklaron: nuk e kundërshtoj padine as kerkes padin ngase është e vërtet se ngastren kadastrale ...XXXX e ka blerë paditesi para disa viteve nga babai im Sh.. S...,dhe e ka paguar ne tërësi.

I Padituri N. S... deklaron:se gjykata në seancat tjera mund të zhvillojë pa prezencen time nga se nuk kam tjetër qka te deklaroj pos kesaj qka e thash në këtë shqyrtim gjyqësor.

I Padituri A..S., djali I S.S... deklaron,nuk e kundërshtoj padine as kerkes padien ngase është e vërtet se ngastren kadastrale XXXX e ka blerë paditsi para dista viteve nga babai im ,e ka paguar ne tërësi ,dhe ka hyrë në posedim dhe shfrytëzim pa u penguar nga askush.

I Padituri A..S... deklaron :se gjykata në seancat tjera mund ti zhvillojë pa prezencen time nga se nuk kam tjetër qka te deklaroj pos kesaj qka e thash në këtë shqyrtim gjyqësor.

Gjykata me dt.XXXX ka dalurë në vendin e ngjarjes në fshatin V... në vendin e quajtur M.. B.. së bashku me ekspertë e gjeodezisë ku ka bërë identifikimin e ngastrave, të lartë permendura që paditësit ti njihet e drejta e pronisies.

Ne proceduren e provave gjykata ka lexuar Certifikaten e pronisies me nr.1-XXXX dt.XXXX në emer te X. X (X), lexohet Certifikata me nr.XXX e dt.xxxx në emer të N.S.(L., lexohet Certifikata me nr.xxx e dt.xxxx në emer të F..x (Sh.), lexohet Certifikata me nr....xxe dt.xxxx, në emer të x.x (x), lexohet ekstrakti nr.E.xxxx në emer të X.X ,që shifet se është djali I N. S., lexohet ekstrakti i lindjes nr.E.XXXX në emer të N.N. djali i S. S, lexohet ekstrakti i lindjes me nr. XXX në emer të A. S. djali i S.S.lexohen ekspertizat nr..XXX,e dt.XXXX të përpiluar nga eksperti I gjeodezisë XXXX.

Paditesi E.E.ne fjalën e fundit të palve : ka deklaruar pas mbajtjes së disa seancave daljes se gjykates ne vendin e ngjarjes me ekspert të gjeodezisë si dhe ekspertizës se ekspertit te gjeodezisë dhe ndëgjimin te të paditurve R. B. nipi i M.B. , N. S. djali i N. S.,N. S. nipi i F. S.dhe A. S. djali i S. S., të cilët në seancën e dt.XXXX,nuk e kanë kundërshtuar padijen e as kërkes padijen dhe kanë pohuar se është e vërtetë se baballarët gjyshet i kanë shitur paditësit E. E.këto ngastra dikur para 30 viteve,dhe i kanë marrur të hollat në tërësi ku paditsi E. E.. ka hyrë ne posedim dhe shfrytëzim pa u penguar nga askush. Andaj kërkojm nga gjykata që të më njihet e drejta e pronisies në ngastrën kadastrale nr.XXX.nr.XXX,nr.XXX dhe në ngastren nr.XXX të gjitha këto në vendin e quajtur "M."ZK.V

I propozoi gjykatës që Gjykata ta aprovon padin dhe kërkes padien dhe të bjen aktgjykim meritor në bazë të ligjit.

Gjykata analizoi thenjet e palve ndergjyqjse, provat e administruara dhe konstatoi: se ngastrat katastrale nr.XXX., e evidentuar ne emer të M...B... (A), ngastres XXX, në emer N... S. (L.), ngastra nr.XXXX në emer të F... S...(Sh...), dhe ngastra nr.XXXX në emer të S... S...X këto ngastëra paditesi E..E.. I kishte blerë nga te paditurit diku para tridhet viteve, që vertetohet nga deklaratat e dhëna në seancë gjyqsore, të djemve-nipave të të paditurvese paditsi i kishte blerë keto ngastra dhe kishte hyer në posedim dhe shfrytzim pa u penguar nga askush, ku dhe sotë paditësi I punon keto ngastra, nga keto arsye,i njihet e drejta e pronsisë, paditsit E. XXX nga fshati XXX, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN -DEGA NE VITI**

**C.nr. 89/2015**

**Me 12.04.2017**

Sek. Juridike:  
Azize Rama

Gj y q t a r i  
Nexhat Aliu

**Kshilla juridike:**kunder ketije aktgjykimi munde te ushtrohet ankese, ne afat prej 15 ditesh nga dita e marrjes, ne Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kesaj gjykate.